REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

SHTATOR 2026

BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS DHE UNITED RIGHTS FOUNDATION



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me organizatë jofitimprurës "United Rights Foundation". Përmes kësaj marrëveshjeve DNJF dhe URF do të bashkëpunojnë për të lehtësuar aksesin në drejtësi të qytetarëve përfitues të ndihmës juridike falas.

TAKIM INFORMUES NË NJËSINË ADMINISTRATIVE VAQARR, TIRANË



Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas zhvilloi ditën e sotme një dëgjesë publike me stafin dhe qytetarët e Njësisë Administrative Vaqarr, me qëllim informimin mbi të drejtën për të përfituar ndihmë juridike falas dhe adresimin e problematikave ligjore të komunitetit.

PËRFAQËSUES TË DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS MORËN PJESË NË TAKIMIN E ORGANIZUAR NGA TLAS DHE QDGR



Përfaqësues të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas morën pjesë në aktivitetin e organizuar nga TLAS dhe QDGR, ku u prezantuan gjetjet dhe rekomandimet për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit dhe përmirësimin e aksesit në ndihmën juridike falas për komunitetet rome dhe egjiptiane.



QSHNJP Sarandë, më datë 30.09.2026, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, zhvilloi një takim pune me Komisariatin e Policisë Sarandë.



QSHNJP Sarandë, më datë 30.09.2026, zhvilloi një takim ndërinstitucional me përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe Zyrës së Përmbarimit Sarandë.




QSHNJP Tropojë, më datë 25.09.2026, zhvilloi një takim ndërinstitucional me DAMT – Zyra Tropojë, me fokus forcimin e bashkëpunimit.



QSHNJP Tropojë, më datë 25.09.2026, zhvilloi një takim ndërinstitucional me Koordinatorin për të Drejtën e Informimit pranë Komisariatit të Policisë.



QSHNJP Tropojë, më datë 30.09.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim, zhvilloi një aktivitet "Street Law" në fshatin "Jaho Salihi".



QSHNJP Tropojë dhe QSHNJP Kukës, më datë 29.09.2026, zhvilloi një takim ndërinstitucional me Dhomën e Avokatisë Kukës, me fokus përmirësimin e koordinimit dhe referimit të rasteve për përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe garantimin e përfaqësimit efektiv ligjor.



QSHNJP Tropojë, më datë 29.09.2026, zhvilloi një takim ndërinstitucional me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.



QSHNJP Tropojë, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me fokus promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.



QSHNJP Tropojë, më datë 30.09.2026, zhvilloi një takim ndërinstitucional me përfaqësues të Shërbimit Social, me fokus forcimin e bashkëpunimit, referimin e rasteve dhe informimin e qytetarëve.



QSHNJP Tropojë, më datë 30.09.2026, zhvilloi një takim ndërinstitucional me Zyrën e Kadastrës pranë Bashkisë Tropojë, me fokus forcimin e bashkëpunimit dhe orientimin e qytetarëve lidhur me problematikat dhe procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.



QSHNJP Shkodër, më datë 23.09.2026, në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, zhvilloi një aktivitet "Street Law" me qytetarët në Koplik.



QSHNJP Shkodër, më datë 23.09.2026, mori pjesë në aktivitetin me temë "Barazia në aksesin e shërbimeve publike", organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi pranë Bashkisë Malësi e Madhe, në kuadër të nismës "Udhëtimi në Shqipëri".

QSHNJP Mat, më datë 10.09.2026, në kuadër të procedurave të referimit dhe menaxhimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, mori pjesë në takimin e Ekipit Teknik Ndërsektorial.



QSHNJP Mat, më datë 30.09.2026, në kuadër të informimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi shërbimin e ndihmës juridike falas, zhvilloi një takim informues pranë Njësisë Administrative Komsi, Bashkia Mat.



QSHNJP Kukës, më datë 10.09.2026, në kuadër të informimit të qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, realizoi një intervistë televizive në RTSH Kukës.



QSHNJP Kukës, më datë 15.09.2026, zhvilloi një takim me znj. Vera Istrefi, drejtuese e OJF-së "Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza Kukës".



QSHNJP Kukës, në kuadër të “Ditës së Kushtetutës Amerikane”, në bashkëpunim me American Corner Kukës, zhvilloi një sesion informues me nxënësit e gjimnazit “Havzi Nela”, ku u trajtuan parime të Kushtetutës së SHBA-së, u bënë krahasime me Kushtetutën e Shqipërisë dhe u prezantuan shërbimet e ndihmës juridike falas.



QSHNJP Kukës, më datë 24.09.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga OSBE-ja në Tetovë, me fokus bashkëpunimin ndërkomunal dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

QSHNJP Kukës, më datë 28.09.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga ADAD Malore në kuadër të Projektit Green-AL.



QSHNJP Kukës, më datë 29.09.2026, mori pjesë në takimin e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Kukës, me temë “Përfshirja dhe aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuara”.



QSHNJP Fier, më datë 15.09.2026, në kuadër të informimit dhe sensibilizimit mbi mbrojtjen e të drejtave në arsim dhe mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve me aftësi të kufizuara, mori pjesë në takimin e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.



QSHNJP Fier, më datë 16.09.2026, në kuadër të informimit mbi mbrojtjen dhe të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin, mori pjesë në takimin e organizuar nga Qendra “Epoka e Re” me temë “Siguria në shkolla – Një hap drejt një komuniteti të sigurt”.



QSHNJP Fier, më datë 22.09.2026, mori pjesë në takimin me anëtarët e grupit teknik të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në Bashkinë Fier.



QSHNJP Fier, më datë 24.09.2026, në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe orientimit të rasteve në nevojë për ndihmë juridike, mori pjesë në takimin e Komunitetit Rajonal dhe Tryezës Teknike për Luftën Kundër Trafikimit, pranë Prefekturës Fier.



QSHNJP Fier, më datë 25.09.2026, në bashkëpunim me KMD, zhvilloi një takim informues pranë Njësisë Administrative Zharrëz, Bashkia Patos.



QSHNJP Fier, më datë 30.09.2026, mori pjesë në fokus-grupin e organizuar nga Terre des Hommes me përfaqësues të institucioneve lokale.



QSHNJP Gjirokastër, më datë 23.09.2026, në kuadër të bashkëpunimit me QSHNJP Përmet, zhvilloi një takim ndërmjet punonjësve të dy qendrave për koordinimin dhe trajtimin e një rasti konkret.



QSHNJP Gjirokastër dhe QSHNJP Përmet, më datë 23.09.2026, në kuadër të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese, zhvilloi një takim me punonjësit e Postës Shqiptare.



QSHNJP Gjirokastër dhe QSHNJP Përmet, më datë 23.09.2026, në kuadër të bashkëpunimit institucional, mori pjesë në një takim me Kryetaren e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër.



QSHNJP Berat, më datë 30.09.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtës për Informim, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues “Street Law”.

QSHNJP Dibër, më datë 23.09.2026, zhvilloi një takim informues në Njësinë Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë.

QSHNJP Dibër, më datë 28.09.2026, zhvilloi një takim informues në gjimnazin “Rifat Manjani”, Bashkia Bulqizë, me fokus informimin e nxënësve dhe stafit të shkollës mbi Ndihmën Juridike.

QSHNJP Korçë, më datë 04.09.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Bamirësisë, zhvilloi një aktivitet sensibilizues në formatin “Street Law”.





QSHNJP Korçë, më datë 15.09.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit dhe Shërbimin Social Shtetëror Devoll, zhvilloi një takim informues në Njësinë Administrative Miras, Bashkia Devoll.



QSHNJP Korçë, më datë 21.09.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra “Treja”, në kuadër të projektit “Promovimi i gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në shkollën Naim Frashëri”.



QSHNJP Korçë, më datë 22.09.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit dhe Shërbimin Social Shtetëror Pogradec, zhvilloi një takim institucional me fokus forcimin e bashkëpunimit.



QSHNJP Korçë, më datë 22.09.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar me rastin e inaugurimit të hapësirave të dedikuara për zhvillimin e takimeve prindërore pranë Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror Pogradec.



QSHNJP Korçë, më datë 25.09.2026, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Punonjësin për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Bashkisë Korçë, zhvilloi një takim informues me nxënësit e shkollës së mesme “Raqi Qirinxhi”.



QSHNJP Pukë, më datë 24.09.2026, në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, zhvilloi një aktivitet informues në terren në qytetin e Pukës, me fokus informimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.



QSHNJP Pukë, më datë 24.09.2026, mori pjesë në tryezën e organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Fushë-Arrëz, me pjesëmarrjen e Bashkisë Fushë-Arrëz dhe përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme vendore, me fokus bashkëpunimin dhe koordinimin institucional për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve.



QSHNJP Vlorë, më datë 10.09.2026, mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Fondacioni “Së Bashku” me temë “Trajnim mbi mbrojtjen nga diskriminimi”.



QSHNJP Vlorë, më datë 21.09.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Paqes, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues me qytetarët, me fokus promovimin e paqes, respektit, dialogut, zgjidhjes paqësore të konfliktеve dhe informimin mbi të drejtat dhe aksesin në drejtësi.



QSHNJP Vlorë, më datë 25.09.2026, mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim, në kuadër të projektit “Fuqizimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile kundër dezinformimit dhe mbrojtjes nga manipulimi dhe ndërhyrja e informacionit të huaj dhe të brendshëm”.



QSHNJP Lushnjë, më datë 21.09.2026, zhvilloi një aktivitet informues dhe bashkëpunues me Shërbimet Sociale të Bashkisë Divjakë, me fokus forcimin e bashkëpunimit institucional dhe orientimin e qytetarëve drejt shërbimeve të ndihmës juridike falas.



QSHNJP Lushnjë, më datë 16.09.2026, zhvilloi një aktivitet “Street Law”, me fokus informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre ligjore dhe mundësitë për përfitimin e ndihmës juridike falas.



QSHNJP Lushnjë, më datë 24.09.2026, mori pjesë në aktivitetin informues të organizuar nga Lëvizja Evropiane Shqiptare (EMA), me fokus procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe Kapitullin 3.



QSHNJP Përmet, më datë 03.09.2026, zhvilloi një takim informues në Njësinë Administrative Dishnicë, Bashkia Këlcyrë, me fokus informimin mbi shërbimet e ndihmës juridike falas, identifikimin dhe referimin e personave në nevojë, si dhe promovimin e këtyre shërbimeve nëpërmjet afishimit të posterit informues.



QSHNJP Përmet, më datë 03.09.2026, zhvilloi një takim informues me punonjësen e Ujësjellës-Kanalizimeve Këlcyrë, me fokus prezantimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas, forcimin e bashkëpunimit për referimin e rasteve në nevojë dhe informimin e qytetarëve nëpërmjet shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe afishimit të posterit informues.



QSHNJP Përmet, më datë 16.09.2026, zhvilloi një takim me Administratorin dhe punonjësit e Njësisë Administrative Çarshovë, me fokus forcimin e bashkëpunimit institucional për informimin, orientimin dhe referimin e qytetarëve në nevojë për ndihmë juridike falas, veçanërisht të banorëve të zonave rurale.



QSHNJP Elbasan, më datë 04.09.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Bamirësisë, zhvilloi një aktivitet informues në formën e “Street Law” për informimin e qytetarëve mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe kategoritë përfituese.



QSHNJP Elbasan, më datë 21.09.2026, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Paqes, zhvilloi një aktivitet informues në formën e “Street Law”, duke informuar qytetarët mbi shërbimet e ndihmës juridike falas dhe promovuar ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.



QSHNJP Elbasan, më datë 28.09.2026, zhvilloi një aktivitet informues në formën e “Street Law” për informimin e qytetarëve mbi ligjin nr. 111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”.



QSHNJP Durrës, më datë 22.09.2026, mori pjesë në trajnimin me temë “Qasje e integruar dhe menaxhim rasti në ofrimin e shërbimeve sociale”.



QSHNJP Durrës, më datë 25.09.2026, në bashkëpunim me Qendrën e Komunitetit të Nishtullës dhe Organizatën “Drejtësi Sociale”, zhvilloi një vizitë në terren pranë komunitetit rom/egjiptian në Nishtullë.



QSHNJP Tiranë, më datë 09.09.2026, në bashkëpunim me organizatën “Të Ndryshëm të Barabartë” dhe Njësinë Administrative nr. 9, zhvilloi një aktivitet ndërgjegjësues mbi Ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

QSHNJP Tiranë, më datë 15.09.2026, mori pjesë në takimin e Grupit Teknik Ndërsektorial (GTN), të zhvilluar në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Njësisë Administrative nr. 2.



QSHNJP Tiranë, më datë 28.09.2026, zhvilloi një aktivitet informues në Njësinë Administrative nr. 2.

.